



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 08 Datë 3.02.2021

**Për përdorimin e Fondit Rezervë, nga Granti & Të Ardhurat**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, duke u bazuar në kërkesën e ardhur nga një grup mjekësh nëpërmjet projektit “Mjekë për Dibrën”, ku Spitali Rajonal Peshkopi synon që të tërheqë mjekë të rinj sipas specialiteteve përkatëse për të ushtruar veprimtarinë e tyre në varësi të nevojave të spitalit. Po i drejtohem këshilli bashkiak për mbështetjen ndaj këtij grupi të mjekëve për miratimin e bonusit të qerasë në masën 50% të vlerës për mjekë specialistë të afruar në qytetin e Peshkopisë: Këshilli Bashkiak pasi rishqyrtoi vendimin **162** date **30.12.2020** të kthyer për rishqyrtim nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 34/1 datë 18.01.2021. Në mbledhjen e tij, vendosi me datë **3.02.2021** me 20 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Lënjen në fuqi të vendimit Nr 162 datë 30.12.2020.
2. Nga fondi kontigjencës i buxhetit të Bashkisë Dibër, t’i jepet ndihmë për bonus qeraje grupit të mjekëve që punojnë në qytetin e Peshkopisë pranë Spitalit Rajonal Peshkopi.
3. Pakësohet të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetëmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vlerën 960,000 (nëntëqind e gjashtëdhjetëmijë ) lekë.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10-të ditë pas shpalljes sipas nenit 55 pika 6 e ligjit 139/2015
6. U shpall sot me datë 8.2.2021

